



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013
Nr.ref.:RK497/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI142/13

Parashtrues

Fadil Maloku

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentes
së Republikës së Kosovës, Nr. 686-2013, të 6 shtatorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Fadil Maloku, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr. 686-2013, të 6 shtatorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr. 686-2013, të 6 shtatorit 2013, përkitazi me ndërprerjen e mandatit të parashtruesit si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KQZ).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin Nr. GJR142/13 caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues dhe me vendimin Nr. KSH142/13 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Prof. dr. Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.
7. Më 8 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Zyrën e KQZ-së, për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 22 tetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 6 shtator 2013, Presidentja e Republikës së Kosovës (Vendimi nr. 686-2013) ia ndërpreu parashtruesit mandatin e anëtarit të KQZ-së. Parashtruesi në KQZ përfaqësonte Grupin parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re.
10. Vendimi i Presidentes për ndërprerjen e ushtrimit të funksionit të anëtarit të KQZ-së bazohet në nenin 139 pikën 4 të Kushtetutës, në nenin 61, paragrafi 5 pikën (a) të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në shkresën e Grupit parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, me nr. protokollin 728, të 20 gushtit 2013, dhe në shkresën me nr. protokollin 743, të 3 shtatorit 2013.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi i kërkesës pretendon së Vendimi i Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr. 686-2013, i 6 shtatorit 2013, shkel të drejtat kushtetuese të parashtruesit të garantuara me: nenin 21 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 [Parimet e Përgjithshme]; nenin 22 paragrafi 1, 2 dhe 3 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut]; nenin 45 paragrafi 3 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; nenin 55 paragrafi 5 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]; nenin 4 paragrafi 1 pika (d) [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar] dhe nenin 18 [Kufiri i Zbatueshmërisë së Kufizimeve të të Drejtave] të KEDNj-së dhe me nenin 19 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut.
12. Parashtruesi, gjithashtu pretendon se Vendimi i Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr. 686-2013, i 6 shtatorit 2013, bie ndesh me nenin 61.5 pikën (a) të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi pohon se ky nen nuk ka të bëjë asgjë me punën e tij si anëtar i KQZ-së. Për më tepër, i njëjti pohon se vendimi në fjalë bie ndesh edhe me nenin 61 pikën (e) që i referohet mandatit dhe emërimit të anëtarëve të KQZ-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

13. Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e parapara për pranueshmëri, të cilat janë të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës.
14. Parashtruesi në rastin konkret është person fizik, i cili kërkesën e tij e bazon në nenin 113.7 (Kërkesat Individuale) të Kushtetutës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafi (7) që përcakton se:

113.7 "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

16. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës, nr. 686-2013, të 6 shtatorit 2013, përkitazi me ndërprerjen e mandatit të parashtruesit si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.
17. Parashtruesi, në këtë rast ka dështuar të provojë që kundër vendimit të kontestuar i ka shteruar mjetet efektive juridike që parashihen me ligjet në fuqi.
18. Prandaj, në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, siç kërkohen me nenin 113.7 të Kushtetutës.
19. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave

themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai ose ajo dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese (*shih, Aktvendimin për papranueshmëri KI41/09, të 21 janarit 2010, AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe shih, mutatis mutandis, ECHR, Selmouni vs. France, no. 25 803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).

20. Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, pasi që parashtruesi nuk i ka shteruar mjetet efektive juridike të parapara me ligj.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 paragrafi (7) të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani